

JOHN GRIGGS

VETURA QË NUK FITUAM

*Nganjëherë perëndesha e fatit me sy të mbyllur
mund të krijojë edhe probleme të mëdha morale*

Ishte koha e vigjiljes së Luftës së Dytë Botërore. Në qytezën e shtetit të New Yorkut ku banonim, ishim e vetmja familje që nuk kishte veturë. Isha adoleshent konformist, e për mua të ishte "pa veturë" nënkuptonte t'i përakisje shtresës më të fundit të shoqërisë.

Kur dilnim për të blerë gjërat e nevojshme, përdornim një karrocë të vogël me dy rrota të tërhequr nga një kalë rrangall e i vogël, të cilit ime më ia kishte ngjitur emrin Barkis, si të personazhit të David Copperfield-it. Kockëdaluri Barkis ishte një fyerje për shikimin. Çdo trokitje e thundrave të tij të shtrembëra i tregonte botës për varfërinë tonë.

Sepse të varfër ishim me të vërtetë. Rroga e tim eti, nëpunës i kategorisë së dytë, do të kishte mjaftuar për të na mbajtur me një farë dinjiteti, sikurse gjysma e saj mos të shkonte për të përballuar mbajtjen dhe shpenzimet për mjekime të disa të afërmëve të sëmurë e nevojtarë. Shtëpia jonë ishte tërësisht e hipotekuar, dhe në dimër kishte raste që bakalli na furnizonte me kredi.

"Kush ka karakter ka pasurinë më të madhe. Të jetosh me pak, mpreh mendjen dhe forcon shpirtin", thoshte ime më për të na ngushëlluar.

Komenti im për një filozofi të tillë ishte: "Po, por nuk mjafton për të blerë një makinë." E. megjithëkëtë, ime më ia delte t'i bënte të durueshme këto mungesa. Shtëpia jonë ishte tërheqëse, sepse nëna dinte të shfrytëzonte mirë pak metra pëlhurë dhe

të përdorte furçën dhe vernikun. Por garazhi vazhdonte të strehonte Barkis-in.

Pastaj, papritur, ndodhi diçka që ngriti turpin tim në një afsh lumturie.

Që prej dy javësh, në vitrinën e dyqanit më të madh të Main Street, qëndronte e ekspozuar një veturë BUICK plot shkëlqim.

Në mbrëmjen e festës së panairit do të hiqej lotaria për autove-turën. Mbasi sodita shpërthimet e fishekzjarreve, u tërhoqa në një anë, në fund të turmës së njerëzve, për të pritur çastin kul-mor: daljen e numrit fitues. E stolisur me shirita e flamuj, mbi një platformë, BUICK-u shkëlqente nën dritat e projektorëve. Kur kryetari i bashkisë futi dorën në enën prej qelqi për të nxjerrë biletën fatmadhe, njerëzit mbajtën frymën.

Kurrë, as në ëndërrimet më të arta, nuk kisha përfytyruar se fati do t'i buzëqeshte të vetmes familje të qytezës që nuk kish-te veturë. E pra, nga autoparlanti kumboi emri i tim eti. Kur, së fundi, ia dola të arrij në tribunë, kryetari i bashkisë ia kishte dorëzuar çelësat tim eti që ishte larguar me makinën, mes duar-trokitjeve të të pranishëmve.

Arrita në shtëpi në një kohë rekord dhe e pashë veten duke nisur makinën për të shoqëruar vajzën që dashuroja në festën e shkollës së saj. Në shtëpi të gjitha dritat ishin të shuara, me përjashtim të dhomës ku rrinim zakonisht. BUCK-u qën-dronte në rrugëzën pranë shtëpisë, i ndriçuar nga drita e drita-res. Nga garazhi vinte frymëmarrja e rëndë e Barkis-it.

Duke dihatur nga vrapimi, përkëdhela sipërfaqen e lëmuar të karrocerisë, hapa sportelin dhe u futa në makinën luk-soze që kishte erën e mrekullueshme të gjërave të reja.

Duke sjellë kokën mbrapa, për të soditur sediljen e fryrë, dallova nga dritarja e vogël e pasme figurën e tim eti. Mbylla sportelin me forcë dhe vrapova drejt tij.

"Më lër të qetë!", thirri ai

Po të më kishte goditur me diçka në kokë, nuk do të më kishte lënduar më shumë. I tronditur hyra në shtëpi.

Gjeta nënën në dhomën e zakonshme.

"Mos u mërzit" më tha "Yt atë është i pushtuar nga një problem moral. Duhet të presim sa të gjejë përgjigjen e drejtë".

Letersi

"Çfarë problemi moral ka të fitosh një BUICK?"

"Po ... ka mundësi që vetura të mos jetë e jona. Ka një problem".

"Si është e mundur?", thirra unë me një ton hysterik. "E kanë thirrur në shesh me altoparant!"

"Eja këtu, djalë.

Mbi tryezë, nën llampadar, gjëndeshin dy koka biletash të lotarisë, numrat 348 dhe 349, Numri fitues ishte 348. "A e sheh ndryshimin?", pyeti nëna.

Shikova me vëmendje. "I vetmi ndryshim që shoh është se 348 ka fituar."

"Shikoje 348-tën nën dritë."

Me vështirësi ia dola të dalloj një "K" të shënuar shumë lehtë me laps në një skaj.

"A e sheh K-në?"

"Sa pak"

"Është inicialia e Kendrick-ut."

"Jim Kendrick? Shefi i babait?"

"Pikërisht ai."

Mandej më shpjegoi çdo gjë. Babai kishte pyetur Kendrick-un nëse dëshironte të blinte një biletë. "Pse jo?", kishte murmuritur Jim-i, duke vazhduar të merrej me punën që kishte në dorë. Ndoshta, më vonë, as që kishte menduar më për atë gjë. Atëherë babai kishte blerë në emër të vet dy bileta dhe kishte shënuar njërin, atë me numër 348, me inicialen e Kendrick-ut, me një shenjë gati të padukshme, që mund të fshihej duke e fërkuar me gisht.

Për mua çështja ishte e zgjidhur, Jim Kendrick ishte një miliarder, kishte shumë makina. Jetonte në një çiflig, kishte një mori shërbyesish mes të cilëve edhe dy shofera. Për të një veturë tjetër kishte më pak rëndësi se do të kishte për ne një paisje e re frerësh për Barkis-in. "Babai duhet ta mbajë për vete!" thashë me afsh. "E di se do të bëjë atë që është e drejtë", tha nëna qetë - qetë.

Së fundi dëgjua hapat e babait mbi verandë. Unë mbajta frymën. Ai hyri, shikoi drejt telefonit dhe bëri një numër. Telefoni i Kendrick-ut tingëlloi gjatë. Së fundi u përgjigj një kamarier. Me sa kuptova, Kendrick-u po flinte.

Ishte nervozuar që e kishin zgjuar, dhe nuk u tregua aspak xhen-

Letersi

til. Babit iu desh t'ia tregonte tërë çështjen që nga fillimi. Ditën e nesërme dy shoferët e Kendrick-ut arritën me një veturë të vogël. Para se të merrnin me vete BUICK-un, i dhuruan babait një kuti me puro.

Nuk ia dolëm të kemi një makinë derisa arrita moshën e pjekurisë. Por, me kalimin e kohës, ajo fraza e nënës sime "Kush ka karakter ka pasurinë më të madhe", fitoi një kuptim të ri. Duke menduar të kaluarën, tani e di se nuk qemë kurrë aq të pasur sa në çastin në të cilin babai bëri atë telefonatë.

Përktheu:
Tomë SHELDIA



G. Ungaretti